

Hapen thirrjet për aplikime në programin e akselerimit OFIÇINA 2018

Are you a STARTUP?

The day has finally come: the application for our next Acceleration Program is now open!

Hapen thirrjet për aplikime në programin e akselerimit **OFIÇINA 2018**

Për të gjithë të rinjtë që duan të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit, hapet thirrja për aplikime në programin e akselerimit **OFIÇINA 2018**.

Je një Startup i ri, ke një produkt/shërbim inovator dhe të nevojitet një ndihmë e specializuar për të krijuar biznesin tënd të ri?

Atëherë, apliko për programin e akselerimit OFIÇINA duke plotësuar formularin online tek www.OFICINA.al

Programi i akselerimit OFIÇINA fokusohet në nxitjen dhe mbështetjen e iniciativave sipërmarrëse inovatore. Për një periudhë 6 mujore Startupet e përzgjedhura do të punojnë ngushtësisht me stafin e qendrës OFIÇINA me qëllim arritjen e objektivave të tyre të biznesit, për një zhvillim sa më të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Përmes një kombinimi të mirë strukturuar workshop-esh, sesioneve të mentorimit, ekspertizave ligjore, financiare, menaxheriale si dhe mundësi angazhimi në aktivitete të ndryshme në fushën e teknologjisë dhe sipërmarrjes, themeluesit e startup-eve do të kristalizojnë idetë dhe planet e tyre të biznesit, do të krijojnë modelin e biznesit si dhe do të kenë finalizuar një produkt të testuar gati për tu lancuar në treg.

Në përfundim të programit të akselerimit, Startup-eve më të mira do t'u ofrohet mundësia për investime të drejtpërdrejta me qëllim zhvillimin më tej të biznesit të tyre.

Si funksionon OFIÇINA?

Faza e parë - Aplikimet

15 aplikimet më të mira do të përzgjidhen për të kaluar në një fazë të dytë prezantimi përpara një paneli ekspertësh. Fituesit e fazës së prezantimit do të fitojnë të drejtën për tu përfshirë në programin e akselerimit OFIÇINA.

Çfarë ofron programi i akselerimit OFIÇINA? Faza e dytë - Akselerimi

Të gjithë fituesit e programit OFIÇINA do të kenë mundësinë të punojnë ngushtësisht me stafin e qendrës OFIÇINA, i përbër nga ekspertë lokal dhe ndërkombëtar, në ambiente pune kreative për të zhvilluar biznesin e nisur. Si pjesë e programit të akselerimit OFIÇINA 2018 fituesit do të jenë të përfshirë në një program intensiv trajnimesh në fushën e të bërit biznes, ekspertiza mbi Startup-in që ata drejtojnë në fushat ligjore, financiare, menaxheriale. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të mentorohen nga sipërmarrës të suksesshëm të programit. Gjithashtu ata do të jenë pjesë e jetës sociale si dhe në eventet e ndryshme që do të zhvillohen pranë OFIÇINA-s.



Ju Pyesni - OFIÇINA Përgjigjet

Kur mund të aplikoj?

Procesi i aplikimit do të vazhdojë të jetë i hapur deri në datën **30 Nentor 2018**.

A duhet të kem një grup pune apo mund të aplikoj edhe si individ?

Preferohet që grupi të jetë i krijuar përpara se ju të paraqisni kërkesën tuaj për aplikim, por gjithsesi nuk do të përjashtohen aplikimet nga sipërmarrës individual, për sa kohë që ata do të jenë të përkushtuar për të ndërtuar një grup pune gjatë programit të akselerimit. Rekrutimi i individëve të aftë përbën sfidë, por ngritja e një grupi pune do të lehtësonte ndërtimin e një biznesi të qëndrueshem dhe të suksesshëm.

A është kusht që sipërmarrja të jetë e orientuar në fushën e teknologjisë së informacionit?

Jo domosdoshmërisht. Programi OFIÇINA është ndërtuar për të nxitur iniciativat sipërmarrëse. Edhe pse preferohen iniciativa në fushën e teknologjisë së informacionit, çdo ide inovatore është e mirëpritur. Ne ju këshillojmë fuqimisht për të aplikuar, pasi programi ka shumë për të ofruar.

A është ky program vetëm për studentët?

JO detyrimisht. OFIÇINA është në mbështetje të të gjitha grupeve të cilët kanë filluar tashmë të zhvillojnë idetë e tyre dhe kanë përkushtimin, energjinë dhe kohën e nevojshme për të ndjekur programin e akseleratorit OFIÇINA.

A mund të marr pjesë nëse jam në një marrëdhënie pune apo jam duke ndjekur studimet?

Sigurisht që PO. Programi OFIÇINA do të përpiqet t'iu përshtatet nevojave tuaja, gjithsesi duhet të keni parasysh që shumica e veprimtarive do të zhvillohen gjatë ditës dhe nuk do të mund të përsëriten në mbrëmje. Është shumë e rëndësishme për punën tuaj që ju të merrni pjesë në aktivitetet e programit të akseleratorit OFIÇINA.

A pranon OFIÇINA aplikantë të cilët vijnë jo nga Tirana?

Patjetër që PO. Akseleratori OFIÇINA mirëpret dhe inkurajon aplikantë nga e gjithë Shqipëria dhe rajoni.

A duhet që të gjithë anëtarët e grupit tim të jenë shqiptarë?

Absolutisht JO. Gjithsesi, për lehtësi komunikimi preferohet të paktën një anëtar i grupit të komunikojë gjuhën shqipe.

A ka një tarifë për të marrë pjesë në programin e akselerimit OFIÇINA?

JO, nuk ka asnjë tarifë për të marrë pjesë në programin OFIÇINA. Mentorët dhe bashkëpunëtorët tanë do të ofrojnë shërbimet e tyre pa pagesë pasi ata besojnë në misionin dhe filozofinë e programit të akselerimit OFIÇINA.

A është i domosdoshëm plotesimi i formularit në gjuhën angleze?

Jo domosdoshmerisht. Formulari mund të plotesohet edhe në gjuhën shqipe por është e këshillueshme që pjestarët e Startup-it të kenë njohuri të gjuhës angleze pasi kjo do të lehtësonte integrimin me ekspertët e huaj që ofron programi.

Çfarë ndodh në rast se përzgjidhem por nuk mund të marr pjesë në program për një javë ose më shumë?

Të gjitha aktivitetet në programin e akseleratorit janë të ndërlidhura dhe kjo është shumë e rëndësishme për zhvillimin e biznesit tuaj. Megjithatë, në situata dhe rrethana të veçanta të cilat do ta bënin të pamundur praninë tuaj, kërkohet njoftimi paraprakisht i stafit të OFIÇINA-s në mënyrë që të vlerësohet mundësia për t'iu përshtatur nevojave.

A merr OFIÇINA një pjesë të kapitalit nga bizneset e regjistruara për programin e akselerimit?

Per këtë thirrje OFIÇINA nuk merr asnjë kapital për ofrimin e paketës së shërbimeve për të gjitha grupet, ku përfshihen shërbimet ligjore dhe mbështetëse, ekspertët e nivelit të lartë si konsulentë, programet softëare, aktivitetet sociale, hapësirat për zyrë, ambientet e takimeve, dhe shumë më tepër.

A do të përfitoj unë fonde në fund të programit të akseleratorit, në DEMO DAY?

OFIÇINA do t'iu ofrojë mundësinë për të prezantuar biznesin përpara investitorëve, por nuk garanton përfitimin e fondeve nga investitorët. Ajo çfarë mund të bëjmë me siguri për ju është përgatitja nëpërmjet praktikave dhe udhëzimeve të ekspertëve më të mira në këtë fushë, për të bërë një prezantim të shkëlqyer përpara investitorëve.

Çfarë ndodh nëse në fund të programit nuk do të kem një biznes të suksesshëm?

Nëse në fund të programit të akselerimit, biznesi juaj nuk do të jetë i

'suksesshëm', ju sigurojmë se do të fitoni një besim më të lartë në vetvete dhe do të jeni të pajisur me njohuri të vlefshme në të bërit biznes dhe një pamje më të qartë në iniciativat e ardhshme si sipërmarrës. Dështimi nuk është alternativë për sukses, ai është diçka që duhet të shmanget, gjithashtu është një pengesë e përkohshme për t'iu drejtuar në një rrugëtim më të madh dhe të rëndësishëm.

